



KËRKESË
“Për heqje dorë”



Drejuar: Z. Xhezair Zaganjori

Kryetar i Gjykatës së Lartë

Për dijeni: Z. Ardian Dvorani

Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Z. Kryetar!

Në zbatim të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 7/a e 7/ç të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” në datën 01.02.2017 kam paraqitur kërkesë, duke shprehur interes për të zëvendësuar Znj. Vitore Tusha në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, meqenëse asaj i ka përfunduar mandati 9 vjeçar.

Më pas në muajin dhjetor të vitit 2018 jam zgjedhur me short nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në detyrën e anëtarit zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për një mandat një vjeçar, i cili më përfundon në fund të vitit 2019, duke marrë pjesë edhe në mbledhjet e zhvilluara nga ky Këshill për miratimin e të gjitha akteve nënligjore, të cilat bëjnë të mundur funksionimin normal të këtij institucioni.

Në nenin 149/d të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 217 e vijues të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” nuk është parashikuar heqja dorë nga detyra e anëtarit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, në mënyrë që unë të kisha mundësi për të vazhduar garën për të qenë njëri prej 3 anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që do të zgjidhen nga mbledhja e posaçme e Gjykatës së Lartë, të cilën e përfaqësoj edhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një mandat 3 vjeçar, prandaj për të mos u gjendur në asnjë lloj konflikti interesash, të parashikuar nga neni 222 e vijues i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në mbledhjet paraardhëse të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi kam deklaruar dorëheqjen time nga kandidimi për të zëvendësuar Znj. Vitore Tusha në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Tiranë, me datë 28.03.2019

KANDIDATI

Medi BICI